

MARMOCRET PLUS Fine

Suva me bazë çimento, me përmbajtje rrëshire Sipërfaqe e lëmuar • E bardhë ose me ngjyrë • Me veti hidrofobe (aftësi ujëlarguese)

Përshkrimi

MARMOCRET PLUS Fine është suva e gatshme (me rërë mermeri) me materiale inerte kokërrimët (deri edhe 1,3mm) që ka nevojë vetëm për shtesë ujë.

- Ofron aftësi ujëlarguese (veti hidrofobe) të plotë nga uji sipas DIN 18550.
- Lejon transpirimin (frymëmarrjen) e shkëlqyer të elementeve konstruktive.
- Fasadat nuk kanë nevojë për lyerje.
- Llaç industrial me veti të standartizuara (konstante).
- I përshtatshëm për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm.
- Nuk plasaritet si suvaja e zakonshme.
- Thjeshtëzon punimet, sepse ka nevojë vetëm për shtesë ujë.

Klasifikohet si llaç i tipit CS II, W2 sipas EN 998-1.

Fushat e përdorimit

Ofrohet për suvatime të bardha ose me ngjyrë, me aftësi ujëlarguese (veti hidrofobe) me sipërfaqe dekorative të lëmuar, në nënshtresa me kërkesa të veçanta në lidhje me aftësinë elastike dhe ngjitshmërinë. Zakonisht zëvendëson dorën e fundit ("të fërkuar" ose "të imët") të suvasë.

Në kombinim me ngjitësen e armuar me fibra Isomat AK-THERMO përdoret si sistem për termoizolim dhe konstruksioneve nga ana e jashtme.

Të dhënat teknike

Trajta:	llaç çimento
Granulometria (përbërja kokometrike):	deri edhe 1,3 mm
Kërkesa për ujë:	5,00 kg / thes 25 kg
Pesha vëllimore e llaçit të thatë:	1,60 ± 0,05 kg/l
Pesha vëllimore e llaçit të njomë:	1,76 ± 0,05 kg/l
Rezistenca në shtypje:	5,25 ± 1,00 N/mm ²
Rezistenca në përkulje:	1,60 ± 0,50 N/mm ²

Rezistenca në ngjitje (pas 28 ditësh):	0,80 ± 0,20 N/mm ²
Ujëthithja kapilare:	≤ 0,2 kg/m ² min ^{0,5}
Koeficienti i përçueshmërisë termike ($\lambda_{10,dry}$):	≤ 0,47 W/(m·K) për P=50% ≤ 0,54 W/(m·K) për P=90%
Koeficienti I difuzionit (shpërndarjes) të avujve të ujit (μ):	5/20
Jetëgjatësia në enë:	4 orë në +20°C

Ngjyrat

MARMOCRET PLUS Fine disponohet në këto ngjyra: e bardhë (N° 100) dhe guacke (N° 207). Ngjyrat e tjera me porosi të veçantë (sasia minimale 5.400 kg).

Mënyra e përdorimit

1. Nënshtresa

Nënshtresa duhet të jetë e pastër, pa pluhura, vajra, materiale të prishura etj. Atje ku konsiderohet e domosdoshme, para se të aplikohet MARMOCRET PLUS Fine, nënshtresa laget mirë ose kalohet me prajmer (astar) PL-PRIMER, i cili zvogëlon thithshmërinë e nënshtresës, duke siguruar kështu ngjyrë uniforme në të gjithë sipërfaqen.

2. Përdorimi

MARMOCRET PLUS Fine shtohet duke u përzier në ujë të pastër, deri sa të krijohet një llaç me punueshmërinë e dëshiruar. Llaçpërzierësja (betoniera) që do të përdoret duhet të jetë e pastër për të evituar çdo influencim të mundshëm në ngjyrën e suvasë.

Suvaja shtrohet me procedurën e njohur me mistri ose përdaf ose me pompë llaçi. Vijon fërkimi i sipërfaqes me fërkuese sfungjeri, pasi është tharë në mënyrë të mjaftueshme. Koha e përpunimit varet nga thithshmëria e nënshtresës, temperatura e mjedisit dhe punueshmëria e llaçit.

MARMOCRET PLUS Fine

Konsumi

Rreth 4 kg/m²/ për shtresë me trashësi 3mm.

Amballazhimi

Thasë 25 kg.

Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në vende të mbrojtura nga lagështia.

Shënime

- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë të paktën +5°C.
- Gjatë muajve verorë rekomandohet lagia e suvasë pas aplikimit të saj, që të mbrohet nga dehidratimi për shkak të temperaturave të larta.
- Produkti përmban çimento, i cili reagon si alkal me ujin dhe klasifikohet si irritues.
- Këshillohuni me udhëzimet për përdorim të sigurt dhe mbrojtjeje të cilat shkruhen në ambllazh.



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

05

DoP No.: MARMOCRET PLUS FINE/ 1228-02

EN 998-1

**General purpose rendering mortar (GP)
for external use**

Reaction to fire: Class A1

Adhesion: 0.6 N/mm² – **FP:** B

Water absorption: W2

Water vapor diffusion coeff.: μ 14

Thermal conductivity: ($\lambda_{10,dry}$) 0.47 W/mK

Durability (against freeze/thaw): evaluation based on provisions valid in the intended place of use of the mortar

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.al e-mail: info@isomat.al

